



МЦМС
МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕГУНАРОДНА
СОРАБОТКА

Diskriminimi në Maqedoni në bazë të përkatësisë etnike

Raport hulumtues

Aleksandar Kërzhalovski

mars 2011

Botues

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Për botuesit

Sasho Klekovski, drejtor i parë ekzekutiv

Aleksandar Kërzhallovski, drejtor ekzekutiv

Autor

Aleksandar Kërzhallovski

Përktheu

Ermira Kuçllar

Përgatiti

Daniella Stojanova, MCMS

ISBN 978-608-4617-12-9

Mendimet që janë shprehur këtu i takojnë autorit dhe nuk do të thotë se i reflekton qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Të gjitha të drejtat janë ruajtur.

Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilës do pjesë të këtij publikimi mund të bëhet vetëm me leje paraprake të botuesit ose për shkak të citimit.

Të drejtat e autorit të këtij publikimi janë mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilën do qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte tjera, për përdorimin në publikime tjera ose për përkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
TERMET DHE DEFINICIONET	4
PARATHËNIE	5
HYRJE	6
RESEYMEJA PËRFUNDIMTARE	8
I. DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE	10
II. DISKRIMINIMI NË SEKTORËT E VEÇANTË	13
Krahasimi i sektorëve	13
II.1. SIGURIA DHE POLICIA	14
II.2. JURISPRUDENCA	14
II.3. FINANCAT	15
II.4. BUJQËSIA	16
II.5. ARSIMI	16
II.6. MEDIUMET	17
II.7. VENDBAIMET, SPORTI, REKREACION	18
II.8. FUSHA E PUNËSIMIT	18
III. PRANUESHMËRIA E UDHËHEQJES POLITIKE	19
IV. LUFTA KUNDËR DISKRIMINIMIT	21
Shtojca 1: Pyetësor anketues për diskriminimin dhe shqetësimin në bazë të përkatësisë etnike	22
Shtojca 2: Ekzemplar i qytetarëve të anketuar	25
Shtojca 3: Te,at në fokus grupet	27

TERMET DHE DEFINICIONET

Në këtë raport shfrytëzohen terme dhe definicione të përfshira në Fjalorin e shprehjeve lidhur me diskriminimin (MCMS, 2009).

Diskriminimi nënkupton çdo dallim, përjashtim, përkufizim ose veprim ose jo veprim jo i barabartë, i motivuar nga baza të kaluara, të tanishme ose të ardhshme, që ka për qëllim ose rezulton me pamundësimin ose vështirësimin e njohjes, gëzimit ose praktikumin e të gjitha të drejtave dhe lirive nga ana e të gjithë personave në bazë të njëjtë, gjegjësisht vënia në trajtim të pavolitshëm të një personi në raport me personin tjetër në situatë të ngjashme.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike do të thotë trajtim jo i njëjtë i individit sepse i takon bashkësisë konkrete etnike.

Shqetësimi nënkupton sjellje të padëshiruar lidhur me disa nga bazat e diskriminimit, pavarësisht nga ajo nëse manifestohet në mënyrë fizike, verbale ose tjetër, që është e drejtuar ose ka për qëllim shkeljen e dinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, degradues, ofendues ose frikësues, qasje ose praktikë.

Spektori publik është pjesë e jetës ekonomike dhe administrative që merret me distribuimin e të mirave dhe shërbimeve prej dhe për shtetin, gjegjësisht që ndodhet nën mbikëqyrje të pushtetit qendror, rajonal ose lokal.

Nën shërbime publike (shërbime dhe servise tjera) nënkuptohen të gjitha shërbimet të cilat kryhen nga cili do institucion privat ose shtetëror, organizatë ose institucion, gjegjësisht të cilat ofrohen nga organ i caktuar ose institucion shtetëror.

Kuotat paraqesin numër fiks të pozitive ose vendeve të cilat mund të plotësohen vetëm nga përfaqësues të bashkësisë të caktuar pakicë.

Stigma/stigmatizimi është veti e padëshiruar ose diskredituese që i jepet një personi ose grupi të njerëzve të drejtuar nga ulja e statusit të personit ose grupit në sytë e bashkësisë.

Toleranca është aftësi që të pranohen dhe të respektohen besimet dhe vlerat shoqërore të personave tjerë ose grupeve të njerëzve.

PARATHËNIE

Parimet për barazi dhe jo diskriminim janë elementet themelore të kornizës ligjore ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut. Këto të drejta veçanërisht janë të orientuara drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut të grupeve në nevojë, të marginalizuara dhe të varfra, si dhe individëve dhe grupeve të përjashtuara sociale. Maqedonia i garanton të drejtat themelore të njeriut dhe liritë fundamentale me Kushtetutë dhe me më shumë ligje, ndërsa ka nënshkruar edhe shumë dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të parapara në sistemin për mbrojtjen e Kombeve të Bashkuara, si edhe në rregullativat evropiane.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) që nga vetë themelimi i promovon barazinë dhe tolerancën, të cilat njëkohësisht janë edhe pjesë nga parimet mbi të cilat bazohet veprimi i saj. Diversifikimi i pranuar kulturor, ndërvarësia dhe dialogu janë një nga qëllimet afatgjate të MCMS-së. Aktivitete më të njohura të MCMS për nxitjen e tolerancës janë fushata E gjithë është kur ka gjithçka dhe programet Faqet për mirëkuptim të ndërsjellë, Bashkëpunimi ndërreligjioz në Maqedoni, Maqedonia pa diskriminim dhe Maqedonia – Model për dialog mes kulturave. Në vitin 2007 MCMS ishte një nga iniciatorët për formimin e Lidhjes “Maqedonia pa diskriminim”.

Në vitin 2004 MCMS në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) përgatiti propozim-ligj për anti diskriminim, i cili nuk u pranua për shqyrtim nga ana e institucioneve përkatëse. Megjithatë, MCMS mori pjesë aktive dhe thelbësore në përgatitjen e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, të miratuar në vitin 2010.

Nga viti 2004, MCMS e mati edhe tolerancën në shoqërinë maqedonase, ndërsa në vitin 2009 e zbatoi edhe hulumtimin “Barometër për mundësi të barabarta”. Paraprakisht e botoi edhe “Fjalorin e shprehjeve lidhur me diskriminimin”. Duke marrë parasysh se MCMS beson në “planifikimin (dhe avokimin) të bazuar në fakte” në vitin 2010 zbatoi edhe dy hulumtime për vlerat shoqërore maqedonase dhe konkretisht për diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike.

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa e zbatuar gjatë hulumtimit “Diskriminimi në Maqedoni në bazë të përkatësisë etnike”. Hulumtimi u mbështet financiarisht nga OSBE, si pjesë e projekteve të tyre për analizën e situatës me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, si pjesë e hulumtimit më të gjerë rreth implementimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, që e zbaton MCMS.

Sasho Klekovski
Aleksandar Kërzhallovski
Bordi i drejtorëve

HYRJE

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa “Diskriminimi në Maqedoni në bazë të përkatësisë etnike”, që u zbatua për herë të parë në ekzemplar reprezentues nacional të qytetarëve të Maqedonisë.

Qëllimi i hulumtimit ishte të hulumtohet perceptimi i qytetarëve rreth kësaj çështjeje, si plotësim i hulumtimit të përmendur.

MCMS anketën për mendimin publik, mbi të cilin bazohet ky raport, ia besoi Institutit për demokraci “Societas civilis” nga Shkupi (IDSCS), përgjegjësia e të cilit ishte edhe rregullsia metodologjike e anketës.

Hulumtimi u zbatua me anketë në terren – intervista “sy më sy” në amvisëritë në dhjetor të vitit 2010 në ekzemplar reprezentues prej 1.074 të anketuar nga ana e IDSCS. Gjithashtu u organizuan edhe dy fokus grupe për kontrollin e rezultateve.

Pyetësi

Pyetësi u përgatit në bazë të pyetësorëve nga anketa të ngjashme të MCMS-së, si dhe në bazë të hulumtimeve globale për vlerat. Pyetjet u përgatitën nga grupi punues në MCMS: Sasho Klekovski, Aleksandar Kërzhhalovski dhe Daniella Stojanova.

Për plotësimin e qëllimeve të hulumtimit, me pyetësin u përfshinë këto tema:

- Konteksti;
- Diskriminimi në gjashtë sektorë konkretë: siguria dhe policia; jurisprudenca; financat; bujqësia; arsimit; dhe mediumet; si dhe në fushën e punësimit;
- Funksionet udhëheqëse dhe lufta kundër diskriminimit; dhe
- Karakteristikat socio-demografike.

I gjithë pyetësi është dhënë në shtojcën 1.

Ekzemplari

Anketa u zbatua në dhjetor të vitit 2010 në ekzemplar reprezentues prej 1.074 të anketuar. Korniza e popullatës së ekzemplarit ishte popullata më e vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentativën ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha dhe rajoni.

Prej 1.074 të anketuar, 47,1% ishin gra, ndërsa 52,9% meshkuj. Lidhur me përfaqësimin etnik maqedonasit marrin pjesë me 66,9%, shqiptarët me 24,4%, ndërsa grupet tjera etnike ishin përfaqësuar me 8,8%. Lidhur me vendin e banimit, popullata fshatare ishte e përfaqësuar me 28,4%, ndërsa ajo urbane me 71,6% (qyteti i Shkupit me 17,2%). Pasqyra e plotë e ekzemplarit është dhënë në shtojcën 2.

Karakteristikat socio-demografike e përfshinë edhe statusin religjioz, të moshës, të punës, perceptimin për statusin social, të ardhurat mujore, simpatitë ndaj partive të caktuara politike etj. Këto parametra janë komentuar vetëm në raste të shmangieve të rëndësishme (mbi 5%) nga rezultatet e përgjithshme.

Fokus grupet

Për kontrollin e disa rezultateve, pas zbatimit të anketës u organizuan dy fokus grupe, njëra e përbërë nga maqedonasit etnik dhe romët, ndërsa tjetra nga shqiptarët etnik. Në të dyja pati nga gjashtë pjesëmarrës. Grupet diskutuan në shtatë tema, në të cilat pati dallime në perceptimin mes qytetarëve me përkatësi të ndryshme etnike. Pasqyra e temave është dhënë në shtojcën 3.

Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Të dhënat e grumbulluara u përpunuan me shpeshti dhe proporcion të përgjigjeve. Të dhënat janë me saktësi prej 95% dhe me gabim prej +/- 5%. Rezultatet janë prezantuar në grafike në nivel të ekzemplarit të përgjithshëm. Përveç grafikeve, të dhënat janë prezantuar edhe në numra.

Në raport nuk janë komentuar analizat socio-demografike për bashkësitë etnike me numër të vogël dhe grupet tjera të vogla socio-demografike për shkak të pjesëmarrjes së tyre të vogël në ekzemplarin nacional.

Në këtë raport në tabela dhe grafike të caktuara nuk janë prezantuar rezultatet për “nuk e di” dhe “pa përgjigje”, për çka shuma e të gjitha përgjigjeve nuk është 100%. Kjo është bërë për nevojat e prezantimit më të thjeshtë të rezultateve.

Për pyetjet ku është kërkuar krahasimi i dy deklaratave të kundërta (me nota prej 1-10), komentimi i rezultateve është bërë sipas parimit të harmonizimit të përgjigjeve nga 1-5 me deklaratën e parë, ndërsa prej 6-10 me deklaratën e dytë (të kundërt). Ku ka grupime të rëndësishme ndaj ndonjë vlerësimi (shpesh 1 ose 10), kjo është komentuar në mënyrë plotësuese.

Pakicë e parëndësishme përdoret për përgjigje më pak se 10% nga ekzemplari, pakicë e vogël për 11% deri 30%, pakicë për 30% deri 50%, shumicë për 51% deri 70% dhe shumicë e madhe për më shumë se 70%.

Në grafiket, me termet “maqedonase” dhe “shqiptare” është theksuar përkatësia etnike e të anketuarve.

Rezultatet nga ky hulumtim, ku ishte e mundur për shkak të pyetjeve të ngjashme/identike, janë krahasuar me rezultatet nga hulumtimi i ngjashëm i realizuar në vitin 2009 (Beshka-Petroska, B., Najçevska, M., 2009). Referencimi i të dhënave nga ai hulumtim është bërë me të përmendurit e vitit (2009).

RESEYMEJA PËRFUNDIMTARE

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa “Diskriminimi në Maqedoni në bazë të përkatësisë etnike”, të zbatuar në kuadër të projektit të MCMS-së, e mbështetur financiarisht nga OSBE në Maqedoni. Vetë anketa është realizuar nga Instituti për demokraci “Societas civilis”, në dhjetor të vitit 2010, në ekzemplar prej 1.074 të anketuar, reprezentues në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike dhe rajonit.

Qëllimi ishte të kontrollohet perceptimi i qytetarëve për diskriminimin në bazë etnike, por edhe përvojat personale si viktimë ose dëshmitarë të diskriminimit, në përgjithësi dhe në sektorë dhe fusha të veçanta. Është bërë edhe krahasimi me hulumtimin e ngjashëm nga viti 2009.

Shumica e qytetarëve (53,3%) mendojnë se **ka diskriminim në Maqedoni**, ndërsa në bazë të **diskriminimit etnik është e dyta më e përfaqësuar** (pas diskriminimit partiak).

Diskriminimi i perceptuar i regjistruar prej 67,7% është më shumë se **dy herë më shumë nga ajo që përjetohet** (si viktimë ose dëshmitar) – 31,9%. Megjithatë, duhet të konstatohet se edhe kjo përqindje flet për nivel relativisht të lartë të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike.

Këto dallime, si edhe theksimi i shembujve konkret, flasin se **jo diskriminimi është akoma koncept në zhvillim në Maqedoni** dhe ka dallime të mëdha në të kuptuarit e termit dhe terminin, komentimi i sjelljes dhe reagimi adekuat (paraqitja e rasteve).

Mbisundon mendimi se **diskriminimi është i shpeshtuar** në pesë vitet e fundit.

Fushat më të shpeshta të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, sipas përvojave personale të qytetarëve janë: marrëdhëniet e punës (**punësimi**), **shërbimet** në sektorin publik (administrata publike, veçanërisht policia dhe shërbimet shëndetësore), por edhe në shërbimet private (kafe-baret, diskotekat, pishinat), si edhe në **arsim**.

Për të gjithë sektorët veçmas mbisundojnë mendimet se ka diskriminim, ku për katër sektorët (shëndetësi, arsim, jurisprudencë dhe siguri/polici) këto janë edhe mendime shumicë (mbi 50% të anketuarve).

Në mënyrë plotësuese, **shqiptarët etnik mendojnë se ka diskriminim më të theksuar** për shkak të përkatësisë etnike **në sektorët bujqësi dhe kulturë**.

Ka dallime në baza etnike dhe në pyetjet për perceptimin e funksionimit të **policisë**, distribuimin e **buxhetit**, (mos)pagesën e **tatimit**, ndarjen e **subvencionimeve**, shkalla e **integritetit në shkolla**.

Shumica e qytetarëve (79%) mendojnë se **diskriminimi në fushën e punësimit është më i shpeshtë në sektorin shtetëror**, se sa në atë privat (54%).

Marrë në përgjithësi, akoma **ka mbështetje të shumicës** (57,9%) pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike që të zgjidhet në funksion të lartë politik, por kjo mbështetje është zvogëluar në raport me vitin 2009 (66%).

Për shumicën e qytetarëve të Maqedonisë, **është e pranueshme** që pjesëtar i një bashkësie tjetër etnike të jetë në njërin nga këto funksione (sipas raportit të përgjigjeve “po” dhe “jo”, prej 1, 3 deri 1): ministër i financave dhe i drejtësisë, prokuror publik, avokat i popullit, kryetar i Këshillit republikan gjyqësor, guvernator i Bankës Popullore, kryetar i Kuvendit, kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe Supreme.

Mbështetje e pakicës është për pjesëtarët e bashkësisë tjetër etnike që të zgjidhet në funksionet: ministër i punëve të jashtme, i mbrojtjes dhe i punëve të brendshme, kryeshëf i Shtatmadhorisë së ARM-së, e më së paku e pranueshme është për funksionet kryetar i Qeverisë dhe kryetar i Republikës së Maqedonisë.

Në të gjitha rastet mbështetja nga maqedonasit etnike është e pakicës (nga 24% deri 45%), derisa nga shqiptarët etnik ka shumicë të madhe (prej 70% deri 78%).

Shumicë e madhe, **72% të qytetarëve do të paraqisnin rast të diskriminimit** në bazë të përkatësisë etnike, nëse u ndodh atyre ose janë dëshmitarë.

Kjo **nuk është në pajtim me përgjigjet** në pyetjet për përvojat personale me rastet e diskriminimit (viktimat ose dëshmitarët) prej 31,9% **dhe praktikës** (numri i rasteve të paraqitura në institucione gjatë viteve të fundit, prej rreth 20 raste në vjet – të gjitha te Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë).

Për dallim nga veprimi i saj diskriminues i perceptuar, **policia është institucioni ku së pari do të drejtoheshin** pjesa më e madhe e qytetarëve në rast të diskriminimit (te shqiptarët etnik para policisë është vetëm Avokati i Popullit).

I. DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE


Që të fitohet përshtypja për nivelin e përgjithshëm të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, janë shtruar disa pyetje për perceptimin lidhur me bazat tjera të diskriminimit dhe për situatën e deritanishme lidhur me atë para pesë viteve, si dhe përvojat personale (viktima ose dëshmitarë) të aktit/rastit të diskriminimit.

Perceptimi për diskriminimin në baza të ndryshme

Shumica e qytetarëve (53,5%, duke marrë vlerën mesatare nga të gjitha përgjigjet “po” në të gjitha bazat) mendojnë se diskriminimi është (shumë ose pothuaj) dukuri e shpeshtë në Maqedoni, përkundër 40,1% të cilët mendojnë se është dukuri shumë ose pothuaj e shpeshtë ose aspak nuk ekziston.

Bindshëm bazë më e shpeshtë për diskriminim është përkatësia partiake, për të cilën 89,9% të qytetarëve mendojnë se është dukuri e shpeshtë. Shumica e qytetarëve si dukuri të shpeshta i veçojnë edhe në bazë të këtyre që vijojnë: **përkatësia etnike (67,7%)**, handikapi (53,8%) dhe orientimi seksual 53,3%. Më të rralla prej tyre janë rastet e diskriminimit (pakica e të anketuarve janë deklaruar se është dukuri e shpeshtë) në bazë të religjionit ose bindjes (45%), moshës (39,8%) dhe gjinisë/seksit (37,3%). Jo përcaktim më të madh ka edhe te njohja e diskriminimit në bazë të orientimit seksual – mbi 10% të qytetarëve janë përgjigjur me “nuk e di” ose aspak nuk janë përgjigjur (te të tjerët kjo përqindje është prej 2 deri 5).

Grafiku 1. Perceptimi për shpeshtinë e diskriminimit në baza të ndryshme në vitin 2010




Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është perceptuar si dukuri e dytë e shpeshtë (pas përkatësisë partiake) në shoqërinë tonë. Këtë e mendojnë pjesa më e madhe e shqiptarëve etnik (84,7%), por edhe shumica e maqedonasve etnik (60,4%). E ngjashme është edhe ndarja edhe sipas besimit – 60,7% të ortodoksëve dhe 82,4% të myslimanëve.

Në krahasim me vitin 2009, renditja e shpeshtisë të bazave të ndryshme të diskriminimit është e njëjtë me përjashtim të moshës, që ishte në vendin e tretë sipas shpeshtisë dhe gjinia/seksi – i cili ka qenë para religjionit/besimit. Ndryshimi që vërehet më shumë është se te të gjitha bazat ka përqindje e madhe e përqindjeve “shpesh” dhe “shumë shpesh”, mesatarisht për 9,5 pikë përqindjes, që flet për perceptim për diskriminim të shpeshtuar. Në bazë të përkatësisë etnike, rritja është për 13 pikë përqindjes (67,7% në vitin 2010 përkundër 54,6% në vitin 2009).

Pjesëmarrësit në fokus grupet si shkaqe për diskriminimin i kanë cekur: mosnjohjen (veçanërisht personalisht) të “tjetrit”, fotografinë që e krijojnë mediumet për bashkësitë etnike, raporti i fuqisë së bashkësive më të mëdha, por edhe si ndikim i faktorëve më të gjerë shoqëror: papunësia, varfëria, nacionalizmi, roli i familjes (tradicionale, patriarkale), flasin edhe për kohëzgjatjen e ekzistimit të diskriminimit.

Krahasimi i perceptimeve lidhur me diskriminimin tash dhe para pesë viteve

Grafiku 2. Nëse e krahasoni situatën e tanishme me atë para pesë viteve, a do të kishit thënë se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është më e shpeshtë ose më e rrallë?




Lidhur me perceptimin për ritjen/uljen e shkallës së diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike¹, si krahasim i situatës tani dhe para pesë viteve, pjesa më e madhe e qytetarëve (38,3%) mendojnë se është më e shpeshtë, përqindje e ngjashme se ka mbetur e njëjtë (34,5%), ndërsa pjesa më e vogël se është më e rrallë (20,9%).

I ngjashëm është raporti i këtyre mendimeve edhe me hulumtimin nga viti 2009, kur 37% kanë menduar se diskriminimi është më i shpeshtë, 33% se është i njëjtë, ndërsa është zvogëluar përqindja e atyre që kanë thënë se është më e rrallë (21% në vitin 2010, përkundër 26% në vitin 2009).

Shumica e shqiptarëve etnik (51,5%) mendojnë se gjendja është keqësuar (më e shpeshtë) në këto pesë vitet, ndërsa 11,5% se është përmirësuar. Për 35,2% të maqedonasve etnik, diskriminimi është më i shpeshtë, derisa për 23,3% gjendja është përmirësuar, gjegjësisht diskriminimi është më i rrallë.

Përvojat personale (viktima ose dëshmitarë) me diskriminimin

Grafiku 3. Në 12 muajt e kaluar personalisht a jeni ndjerë të diskriminuar/të shqetësuar për shkak të përkatësisë etnike?



Përkundër perceptimit për shpërndarjen e gjerë të diskriminimit etnik (67,7%), kur qytetarët janë pyetur për përvojën personale me rast të diskriminimit të tillë gjatë vitit të kaluar, 1 prej 5 qytetarëve (19,1%) deklarojnë se personalisht kanë ndjerë (kanë qenë viktimë) e diskriminimit ose shqetësimit, ndërsa çdo i katërti (23,4%) ka qenë dëshmitar.

Këtu duhet të theksohet se ka përputhje të pjesshme të përgjigjeve, gjegjësisht se personat e njëjtë kanë qenë edhe viktima edhe dëshmitarë të diskriminimit. Gjithsej 31,9% të anketuarve kanë qenë viktima ose dëshmitarë të diskriminimit. Në fokus grupet, të gjithë pjesëmarrësit kanë deklaruar se kanë qenë viktima ose dëshmitarë të diskriminimit.

Në krahasim me vitin 2009, kur 33,5% të anketuarve kanë deklaruar se kanë qenë viktima të diskriminimit në njërin nga bazat, mes tyre 12,9% në bazë të përkatësisë etnike, ose rritja për 6,2 pikë përqindjes (19,1% në vitin 2010). Është rritur edhe përqindja e dëshmitarëve të diskriminimit (23,4% përkundër 15,2% në vitin 2009).

Lidhur me përkatësinë etnike të anketuarve, është vërejtur dallim në pyetjen për diskriminimin personal (viktima), kur me "po" janë përgjigjur 29,9% të anketuarve shqiptarë etnik, ndërsa 9,9% të maqedonasve etnik. Në pyetjen a keni qenë dëshmitarë të diskriminimit, nuk ka dallim të dukshëm (përqindja e përgjigjeve në bazë etnike është me vogël prej +/-5% nga përqindja e përgjithshme prej 23,9%).

¹ Më tej të gjitha pyetjet kanë të bëjnë me diskriminimin mbi këtë bazë, e ku ndryshe është cekur përdorimi i termit "diskriminim" do të nënkuptohet se ka të bëjë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike.

Është interesante se në këtë pyetje, prej atyre që kanë deklaruar se personalisht kanë qenë të diskriminuar, dyfish më shumë janë meshkuj (65% përkundër 25% të grave), e diçka më pak është raporti i pyetjes për dëshmitarë të diskriminimit (58% përkundër 42%). Kjo është një nga pyetjet e rralla në hulumtim ku ka dallime të dukshme statistikore (mbi 5%) lidhur me gjininë.

Fokus grupet, duke marrë parasysh se të gjithë kanë deklaruar se kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të diskriminimit, mendojnë se këto perceptime janë edhe më të mira se sa në realitet. Si argumente janë cekur: frika nga dëshmimi për diskriminimin e vërejtur, heshtja, bile edhe orvatja të harrohen ngjarjet e tilla. Grupi me shqiptarët etnik mendon se edhe çdo shqiptar të pakjtën një herë ka qenë viktimë e diskriminimit.

Si pjesë e këtyre pyetjeve, nga të anketuarit është kërkuar edhe të cekin shembull nga përvoja personale (si persona të diskriminuar ose dëshmitarë të diskriminimit ndaj ndonjë personi tjetër). Për tu theksuar është niveli i lartë i përgjigjeve (19,5%) nga e zakonshmja nga anketat paraprake dhe korrespondenca me nivelin e përvojave personale me rastet e diskriminimit, edhe pse përsëri në pjesën më të madhe përgjigjet janë shumë të përgjithshme (p.sh. në punë ose për punësim, në kafene, në fakultet, ndaj romëve etj.).

Gjithashtu, në përgjigjet ka përzierje të përvojave personale si viktima dhe dëshmi, pastaj në baza (edhe pse pyetja ishte vetëm për përkatësinë etnike) dhe fushat (p.sh. marrëdhëniet e punës, shëndetësia, arsimit), theksimi i organizatave/institucioneve konkrete (si për shembull MPB ose EVN), por jo edhe për atë se në çka përbëhej diskriminimi (veçanërisht nëse kjo ka qenë për shkak të përkatësisë etnike), si dhe formulime të cilat kanë të bëjnë me veprimin jo të barabartë, por nuk llogariten për diskriminim (p.sh. kuotat në fakultet).

Edhe në fokus grupet sipas shembujve të cilat i kanë dhënë, është vërejtur inkuadrim edhe i dukurive të cilat nuk janë diskriminim (diskutimet verbale, ofendimet, stereotipat). Në mënyrë plotësuese, ndaj zgjidhjes së perceptimit ndikojnë edhe rrëfimet personale të dëgjua nga njerëz që njohim, si dhe kohëve të fundit – rrjetet sociale, ku forcohen stereotipa dhe paragjykimet, me çka nxitet diskriminimi.

Përfundime

Shumica e qytetarëve (53,3%) mendojnë se **ka diskriminim në Maqedoni**, e në bazë të **diskriminimit etnik është e dyta më e përfaqësuar** (pas përkatësisë politike).

Diskriminimi i perceptuar i regjistruar prej 67,7% është **dy herë më i madh se sa ai i përjetuar** (si viktima ose dëshmitar) – 31,9%. Megjithatë, duhet të konstatohet se edhe kjo përqindje flet për nivel relativisht të lartë të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike.

Këto dallime, si edhe cekja e shembujve konkret, flasin se **jo diskriminimi akoma është koncept në zhvillim në Maqedoni** dhe ka dallime të mëdha në të kuptuarit e termit dhe termeve, komentimit të sjelljeve dhe reagimi adekuat (paraqitja e rasteve).

Mbisundon mendimi se **diskriminimi është i shpeshtuar** gjatë 5 viteve të fundi.


Fusha më të shpeshta të diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike, sipas përvojave personale të qytetarëve janë: marrëdhëniet e punës (**punësimi**), **shërbimet** në sektorin publik (administrata publike, e veçanërisht policia dhe shërbimet shëndetësore), por edhe në shërbimet private (kafenetë, diskotekat, pishinat), si edhe **arsimi**.

II. DISKRIMINIMI NË SEKTORËT E VEÇANTË

Krahasimi i sektorëve

Si hyrje në analizën e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike në disa sektorët të veçantë, të anketuarit janë pyetur për vlerësimin e përgjithshëm të prezencës së kësaj forme të diskriminimit në secilin prej këtyre sektorëve:

Grafiku 4. Perceptimi i diskriminimi në fusha të ndryshme, sipas raportit të përgjigjeve




Për të gjithë sektorët e përmendur mbisundojnë p mendimet se ka diskriminim (në raport prej 1,2 deri 2,0 ndaj mendimeve se ka), me çka për katër sektorë (shëndetësi, arsim, gjyqësi dhe siguri/polici) këto janë mendime shumicë (mbi 50% të anketuarve mendojnë se ka diskriminimin në atë sektor). Përqindje relativisht e lartë e qytetarëve (prej 9 deri 26%) nuk kanë pasur mendim për këtë pyetje.


Në shumicën e sektorëve nuk ka aspak ose është i parëndësishëm (< 5%) dallimi i përgjigjeve mes maqedonasve dhe shqiptarëve etnik. Përkundrazi janë bujqësia dhe kultura. Për sektorin bujqësi, 53,1% të anketuarve shqiptarë etnik kanë deklaruar se ka diskriminim në dhënie e shërbimeve, derisa te maqedonasit etnik kjo përqindje është 37,3%. Te kultura ky raport është 53,8% (te shqiptarët) përkundër 38,7% (maqedonasit).

Grafiku 5. Perceptimi i diskriminimit në sektorët sipas përkatësisë etnike:

a) bujqësia



b) kultura



Në vazhdim janë analizuar përgjigjet për disa nga sektorët e zgjedhur.

II.1. SIGURIA DHE POLICIA

Në sektorin siguri/polici, qytetarët janë pyetur për shërbimet si mbrojtja, intervenimet, por edhe dhënia e lejeve, certifikatave, dokumenteve të udhëtimit, letrat e njoftimit, shtetësia etj.

Gjithsej 55,7% të anketuarve mendojnë se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në këtë sektor, ndërsa 34,4% se nuk ka (raporti është 1,62). Nuk ka dallime të mëdha në përgjigjet e maqedonasve etnik (54,4% kanë thënë “po”) dhe shqiptarët etnik (58,0%).


Diskriminimi në bazë etnike në fushën e sigurisë, gjegjësisht policia, është hulumtuar me dy pyetje (në shkallën prej 1 deri 10): Policia e (nuk) siguron rendin publik dhe sigurinë pa dallim të strukturës etnike të bashkësisë; dhe Policia i ndjek kriminelët (pa dallim të) / (varësisht nga) përkatësia e tyre etnike.

Tabela 1. Qëndrime lidhur me diskriminimin në sigurimin e shërbimeve nga policia

Policia e siguron rendin publik dhe sigurinë pa dallim të strukturës etnike të bashkësisë (1-5)	57,3%	42,4%	Policia nuk e siguron rendin publik dhe sigurinë në bashkësinë time për shkak të strukturës etnike (6-10)
Policia i ndjek kriminelët pa dallim të përkatësisë së tyre etnike (1-5)	59,9%	39,5%	Policia i ndjek kriminelët varësisht nga përkatësia e tyre etnike (6-10)

Në raport me pyetjen e parë, shumica e qytetarëve (57,3%) mendojnë se struktura etnike e bashkësive nuk ka ndikim në raportin e policisë ndaj tyre. Por, nëse shihen përgjigjet sipas bashkësive etnike, përfundohet se mendimin e këtyllë të përgjithshëm ndikon kryesisht qëndrimi i maqedonasve etnik (61,3% në pajtim me deklaratën e parë), derisa të shqiptarët etnik ky është mendim pakicë (43,1%).

Grafiku 6. Dallime në qëndrimet për policinë mes bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare



Pothuaj njëloj (diçka më mirë) është vlerësuar për atë nëse policia diskriminon gjatë ndjekjes së kriminelëve, ku 59,9% mendojnë se nuk ka diskriminim, gjegjësisht kriminelët ndiqen pa dallim të përkatësisë së tyre etnike.

Edhe këtu distribuimi i të anketuarve është si lartë – derisa 64,1% të maqedonasve etnik pajtohen me deklaratën e parë, shumica e shqiptarëve etnik (55,3%) përputhen ndaj të kundërtës – se policia i ndjek kriminelët varësisht nga përkatësia etnike.

Në fokus grupet është theksuar se një pjesë e diskriminimit ka të bëjë me presionin nga bashkësia e vet etnike të policëve, për dënim më të butë (ose mos dënim) gjatë kundërvajtjeve të bëra. Kështu, mendojnë ata, nuk ka dallim në bazë etnike, gjegjësisht ka raste të tilla të çdo bashkësi etnike. Për tu theksuar është edhe mendimi se me përmirësimin e bilancit etnik (veçanërisht me rritjen e numrit të policëve – shqiptarët etnik), ka raport më konkret ndaj qytetarëve. Akoma përjashtim paraqesin romët, të cilët edhe më tej janë më pak të përfaqësuar në polici, ndërsa stereotipat për bashkësinë e tyre edhe më tej janë prezent dhe rastet e sjelljes së perceptuar diskriminuese ndaj tyre – më të shpeshta.

II.2. JURISPRUDENCA

Në sektorin jurisprudencë, qytetarët u pyetën për shërbimet e prokurorisë, gjykatave dhe institucioneve për kryerjen e sanksioneve.

Gjithsej 54,2% të anketuarve mendojnë se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në këtë sektor, ndërsa 28,0% se nuk ka. Raporti është 1,93 dhe me këtë është perceptuar si sektori i tretë sipas shpeshtisë së diskriminimit. Diçka më shumë është numri i shqiptarëve etnik (59,9%) të cilët e mendojnë këtë, në raport me maqedonasit etnik (51,0%).

Njëlloj si edhe te siguria, me dy pyetje është hulumtuar diskriminimi në fushën e jurisprudencës, por ka ndarje të mëdha në përgjigjet. Përsëri, shumica e qytetarëve (55,4%) janë pozitiv në krahasim me gjykatat (mendojnë se i udhëheqin procedurat pa marrë parasysh përkatësinë etnike), por shumica e qytetarëve (17,2% gjegjësisht 17,8%) janë në pozita ekstreme (nota 1 gjegjësisht 10).

Tabela 2. Qëndrime lidhur me diskriminimin në sigurimin e shërbimeve nga jurisprudenca

Sundimi i të drejtës dhe aplikimi i ligjeve zbatohet njëjloj në gjithë territorin e vendit pa marrë parasysh strukturën etnike	39,1	60,5	Sundimi i të drejtës dhe aplikimi i ligjeve nuk zbatohet njëjloj në gjithë territorin e vendit varësisht nga struktura etnike
Gjykatat i udhëheqin procedurat dhe i caktojnë dënimet pa dallim të përkatësisë etnike	55,4	43,9	Gjykatat i udhëheqin procedurat dhe i caktojnë dënimet varësisht nga përkatësia etnike

Nga ana tjetër, shumica e qytetarëve (60,5%) mendojnë se sundimi i të drejtës dhe aplikimi i ligjeve nuk zbatohet njëjloj në gjithë territorin e vendit.

Nuk ka dallime të mëdha në bazë etnike, gjegjësisht edhe shumica e maqedonasve etnik (66%) dhe shqiptarët etnik (75%) janë të mendimit të njëjtë. Lidhur me shpërndarjen rajonale, pjesa më e madhe e personave me mendim të këtyllë janë nga rajoni i Pollogut dhe pjesërisht nga ai i Shkupit.

II.3. FINANCAT

Në sektorin e financave (publike), qytetarët u pyetën për doganat, tatimet, procesin e denacionalizimit.

Gjithsej 47,2% të anketuarve mendojnë se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në këtë sektor, ndërsa 30,7% se nuk ka (raporti është 1,54). Nuk ka dallime të mëdha në përgjigjet e maqedonasve etnik (46,7%) dhe shqiptarëve etnik (50,4%).


Çështja e financave është shqyrtuar nga aspekti i buxhetit (distribuími sipas bashkësive etnike), pagesa e tatimeve (gjegjësisht sanksionimi i mos pagesës), si edhe qasja deri te kreditë për bashkësitë e ndryshme etnike.

Tabela 3. Qëndrimet lidhur me diskriminimin në sektorin e financave (publik dhe privat)

Buxheti i Republikës së Maqedonisë shpërndahet në bazë të kriterëve objektive pa dallim të përkatësisë etnike	51,4%	47,5%	Buxheti i Republikës së Maqedonisë shpërndahet me favorizimin e bashkësive tjera etnike (jo timen).
Mos pagesa e tatimeve sanksionohen pa dallim të përkatësisë së tyre etnike	33,5%	65,0%	Pjesëtarët e disa bashkësive etnike nuk paguajnë tatime, ndërsa kjo nuk sanksionohet
Qasja deri te kreditë në bankat sigurohet pa dallim të përkatësisë etnike	79,8%	19,9%	Bankat në qasjen deri te kreditë i favorizojnë bashkësitë tjera etnike (jo timen)

Tërësisht është i ndarë mendimi për shpërndarjen e buxhetit (51,4% mendojnë se shpërndahet pa dallim të përkatësisë etnike, ndërsa 47,5% mendojnë se favorizohen bashkësitë tjera etnike. Këtë (të dytën) e mendojnë 75,6% të shqiptarëve etnike. Në këtë fokus grup janë theksuar shembuj për investime të pamjaftueshme (ose joproporcionale) në infrastrukturë (rrugët, parqet, kanalizimi, ndriçimi, sallat sportive).

Grafiku 7. Dallimet etnike në perceptimin e shërbimeve financiare




Mosbesimi është më i madh i qytetarëve se ata që nuk paguajnë tatim sanksionohen njëjloj (65%), me çka përqindje e lartë (34,4%) është e bindur në atë. Këtu maqedonasit etnik janë diç më të përfaqësuar (69,2% përkundër 60,7% shqiptar etnik). Në fokus grupi me shqiptarët e ntik, ka pasur pajtim se ata më pak paguajnë tatim, duke e sqaruar këtë me papunësinë. Gjithashtu edhe nga romët në fokus grupet është potencuar se përkundër stereotipave për mos tatimimin e tregut në Shuto Orizari, kjo nuk është kështu.

Përkundër kësaj, shumicë e madhe (79,8%) të anketuarve mendon se ka qasje të barabartë deri te bankat (kreditë dhe shërbimet tjera financiare) për të gjithë bashkësitë etnike. I ngjashëm është vlerësimi (82,5% përkundër 72,9%) te dy bashkësitë më të mëdha etnike.

II.4. BUJQËSIA

Në sektorin e bujqësisë, me interes të veçantë ishin pyetjet për subvencionimet, si edhe të lejeve të ndryshme (koncesione etj.) dhe qasja deri te IPARD mjetet.

Grafiku 8. Qëndrimet lidhur me diskriminimin në bujqësi (duke përfshirë subvencionet)



Gjithsej 40,7% nga të anketuarit mendojnë se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në këtë sektor, ndërsa 33,5% se nuk ka. Raporti është 1,21 dhe me këtë është perceptuar si një nga sektorët më pak të diskriminuar. Por, këtu ka dallim më të madh në qëndrimet mes maqedonasve etnike (37,7% mendojnë se ka, ndërsa 25,7% se nuk ka diskriminim) dhe shqiptarëve etnik (53,1% thonë se ka, përkundër 27,9%).

Shumica e qytetarëve (59,3%) mendojnë se „subvencionet në bujqësi miratohen mbi kriteret pa dallim të përkatësisë etnike”. Por, ka dallime në bazë të përkatësisë etnike të anketuarve, pasi që pakica e shqiptarëve etnik (32,8%) pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa 67,2% jo, gjatë kësaj 38,9% shprehin mospajtim të plotë.

Lidhur me përfaqësimin rajonal, në shumicën e rajoneve dominon mendimi për shpërndarje adekuate. Dallim nga ekzemplari ka në rajonin e Pollogut (për 10 pikë përqindjes), të Pellagonisë (për 5) dhe pjesërisht në rajonin Juglindor.

II.5. ARSIMI

Në sektorin e arsimit, qytetarët u pyetën për shërbimet si regjistrimi në shkollat shtetërore, dhënia e bursave, akreditimet, nostrifikimi i diplomave.

Gjithsej 59,3% të anketuarve mendojnë se ka diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në këtë sektor, ndërsa 31,5% se nuk ka (raporti është 1,88, me çka arsimit është perceptuar si sektori i dytë me shpeshti të diskriminimit). Është interesante se përqindja e përgjigjeve të maqedonasve etnike dhe shqiptarëve etnik është e ngjashme – rreth 59% kanë thënë “po”, ndërsa 32% “jo”.

Ky perceptim, por edhe rastet e ndarjeve etnike, jotoleranca dhe dhuna në shkollat, kanë prejardhjen nga disa stereotipa, për të cilat u pyetën qytetarët në këtë anketë.

Tabela 4. Qëndrimet për zhvillimin e mësimin lidhur me përkatësinë etnike

Nxënësit nga bashkësia e njëjtë etnike duhet të mësojnë në shkolla të integruara	50,1%	49,0%	Nxënësit nga bashkësia e njëjtë etnike duhet të mësojnë në shkollë të njëjtë në ndërtesë të veçantë
Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike në shkollë të njëjtë, duhet të mësojnë në ndërrim të njëjtë	57,7%	41,9%	Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike në shkollë të njëjtë, duhet të mësojnë në ndërrime të ndryshme
Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike të cilët mësojnë në gjuhë të njëjtë duhet të mësojnë në paralele të përziera etnike	59,4%	40,0%	Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike të cilët mësojnë në gjuhë të njëjtë duhet të grupohen në paralele etnikisht të ndara
Romët duhet të mësojnë të grupuar në paralele etnikisht të përziera	63,6%	36,1%	Romët duhet të grupohen në paralele rome


I pari prej tyre është nëse nxënësit nga bashkësia e njëjtë etnike në një shkollë duhet të mësojnë në ndërtesë të veçantë ose në të njëjtë (mjedis i integruar/i përzier). Qytetarët janë plotësisht të ndarë rreth kësaj çështje (49.0% përkundër 50,1%), megjithatë me përgjigje më të shumta (33,6% ose çdo qytetar i tretë) për arsim të integruar, ndërsa edhe ndarja nuk është në bazë etnike (47% të maqedonasve dhe 51% të shqiptarëve).

Në të dy fokus grupet janë theksuar përparësitë e shkollave të integruara, por shumica e pjesëmarrësve në ato kanë deklaruar se nuk do ti kishin dërguar fëmijët e tyre në shkollë të tilla, kryesisht duke e arsyetuar atë me perceptimin për sigurinë e zvogëluar në shkollat, si dhe potencialin për konflikt.

Dilema e dytë është nëse nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike duhet të mësojnë në ndërrim të njëjtë ose të ndryshëm. Këtu ka pajtueshmëri më të madhe për integrim (57,7%), por dallohen qëndrimet e shqiptarëve etnik, të cilët në përqindjen afër të njëjtë megjithatë janë për të mësuar në ndërrime të ndryshme.

Pastaj, qytetarët u pyetën nëse nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike të cilët mësojnë në gjuhë të njëjtë duhet të mësojnë të grupuar në paralele etnikisht të ndara ose në paralele të njëjta (etnikisht të përziera). Tendenca ndaj integritit më të madh vazhdon (59,4%) ku 40,6% janë tërësisht për të mësuarit e bashkësive etnikisht të ndryshme në paralele të njëjta. Megjithatë edhe këtu shumica e shqiptarëve etnik (57,3%) preferojnë paralele etnikisht të ndara.

Grafiku 9. Qëndrimet lidhur me diskriminimin/integrimit sipas përkatësisë etnike




Më në fund, çështje e veçantë u shtrua për raportin ndaj romëve – nëse ata duhet të mësojnë në paralele të veçanta (rome) ose në paralele etnikisht të përziera. Në këtë pyetje është edhe pajtueshmëria më e madhe për integrim 63,6% (duke përfshirë 45,2% me pajtueshmëri maksimale). Përsëri, mbështetja për këtë te shqiptarët etnik është pakicë (40,8% janë “për”, ndërsa 59,2% “kundër”).

II.6. MEDIUMET

Lidhur me mediumet, me interesim për hulumtimin ishte nëse ato mjaft mirë e pasqyrojnë realitetin multi-etnik të Maqedonisë dhe nëse me të vërtetë vetë mediumet nxisin diskriminim, stigmatizim ose shqetësim të ndonjë bashkësie etnike.

Grafiku 10. Qëndrimet lidhur me diskriminimin, stigmatizimin ose shqetësimin në mediumet



Në pyetjen e parë, 42,6% të qytetarëve mendojnë se “bashkësitë etnike janë mjaft mirë të pasqyruara në mediumet”, gjegjësisht se **diversifikimi** në shoqërinë maqedonase është mirë i pasqyruar në mediumet, ndërsa 32,6% se jo.

Për dallim nga kjo, 62,3% mendojnë se “mediumet sillen në mënyrë diskriminuuese, gjegjësisht **stigmatizohen gjatë raportimit për disa bashkësi etnike**”.

Ka balancim relativisht etnik të këto çështje, me dallim të vogël të e dyta, ku 13% më shumë shqiptarë etnik se sa maqedonas etnik mendojnë se ka diskriminim në prezantimin medial të bashkësive etnike.

II.7. VENDBAIMET, SPORTI, REKREACION

Shumicë e madhe e qytetarëve 74,7% janë të mendimit se qytetarët duhet të jetojnë në mjedise etnikisht të përziera.


Gjithashtu 85,8% mendojnë se qasja deri te objektet për sport, rekreacion, argëtim, hotelieri duhet të jetë njëlojë për të gjithë qytetarët.

Në të dy rastet nuk ka kurrfarë lëshimesh në raport me përkatësinë etnike.

II.8. FUSHA E PUNËSIMIT

Punësimi, pa marrë parasysh sektorin, është perceptuar si fushë e shpeshtë e diskriminimit (edhe në bazë etnike, por edhe në baza të tjera) edhe në këtë hulumtim, si edhe në pjesën tjetër më të madhe në Bashkimin Evropian.

Grafiku 11. Bashkësitë tjera etnike marrin vende pune nga e imja



Çdo i dyti qytetar i Maqedonisë (47,4%) mendon se bashkësitë tjera etnike marrin vende pune nga bashkësia e tyre (derisa 23,8% nuk pajtohen me këtë), gjithashtu nuk ka dallim sipas përkatësisë etnike të anketuarve.


Sipas fokus grupeve, për shqiptarët etnik problemi qëndron në diskriminimin paraprak afatgjatë në institucionet shtetërore dhe firmat e mëdha private, ku akoma në pozitë që vendosin për punësim kryesisht gjenden maqedonasit etnik, derisa të bashkësitë tjera etnike e cekin Marrëveshjen kornizë si favorizuese për shqiptarët etnik.

Shpërndahet mendimi (gjithsej 66,9% dhe 48,5% me notë 10) se edhe në kushte të mungesës së mundësive për punësim, zgjedhja duhet të jetë mbi kritere objektive, pa dallim të përkatësisë etnike. Për këtë angazhohet shumica (70,9%) të maqedonasve etnike, por edhe 54,6% të shqiptarëve etnike.


Duke e krahasuar sektorin shtetëror dhe atë privat, ngjashëm si edhe te financat (buxheti përkundër bankave) qytetarët mendojnë se më shumë diskriminim ka në sektorin shtetëror (79,3%, ndërsa 11% se nuk ka), përkundër atij privat për të cilin 54% mendojnë se ka diskriminim, ndërsa 31,7% se nuk ka. Këtë e vërtetojnë edhe fokus grupet.

Grafiku 12. Diskriminimi gjatë punësimit në sektorin shtetëror dhe privat

a) perceptimi për diskriminim



b) pajtueshmëri për masat afirmative



Siç shihet në grafikonin 9, ka dallime etnike gjatë vlerësimit të diskriminimit gjatë punësimit dhe atë shqiptarët etnik në përqindje të madhe besojnë se ai gjendet në sektorin shtetëror (89,3% përkundër 75,5% nga maqedonasit etnik), derisa maqedonasit përsëri më shumë (55%) nga shqiptarët etnik (49,2%) e mendojnë të njëjtën, por për sektorin privat.

Megjithatë, të gjithë pajtohen me vendosjen e masave specifike për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit të personave nga bashkësitë etnike jo shumicë (p.sh. programe speciale për trajnim, kuotat për punësim, nxitjet tatimore, vendosja e standardeve për përgjegjësi shoqërore etj.), pothuaj njëloj për sektorin shtetëror (73,2%) dhe atë privat (67,4%) dhe ngjashëm është me mbështetjen (66%) për këtë në vitin 2009.

Përfundime për diskriminimin në sektorë dhe fusha të veçanta

Për të gjithë sektorët veçmas të hulumtuar mbisundon mendimi se ka diskriminim, me çka për katër sektorët (shëndetësi, arsim, jurisprudencë dhe siguri/polici) këto janë edhe mendime shumicë (mbi 50% të anketuarve).

Në mënyrë plotësuese për këtë, **shqiptarët etnik mendojnë se ka diskriminim më të theksuar** për shkak të përkatësisë etnike **në sektorët bujqësi dhe kulturë**.


Ka dallime në bazë etnike edhe në pyetjet për perceptimin e funksionimit të **policisë**, ndarjes së **buxhetit**, (mos)pagesa e **tatimit**, ndarja e **subvencionimeve**, shkalla e **integritimit në shkolla**.

Shumica e qytetarëve (79%) mendojnë se **diskriminimi në fushën e punësimit është më i shpeshtë në sektorin shtetëror**, se sa në sektorin privat (54%).

III. PRANUESHMËRIA E UDHËHEQJES POLITIKE

Kjo pjesë e hulumtimit ka të bëjë me pranueshmërinë për kryerjen e funksioneve më të larta shtetërore nga ana e pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike, si dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi.

Grafiku 13. Pranueshmëria e bashkësisë tjetër etnike për funksion të lartë shtetëror



Për shumicën e qytetarëve (57,9%) është e pranueshme të zgjidhet në funksion të lartë politik (përkundër 34,9% për të cilët është e papranueshme). Derisa për të gjitha bashkësitë etnike pakicë pothuaj pa përjashtim është e pranueshme një gjë e tillë, te maqedonasit etnik ka ndarje të plotë rreth kësaj pyetjeje (për 47,8% është e pranueshme, por për 43,6% nuk është). Sipas fokus grupit me maqedonasit etnik, mbështetja është, kushtëzuar me kryerjen profesionale të

funksionit, e jo favorizimi i bashkësisë së vet etnike (sipas tyre siç kanë qenë përvojat e deritanishme). Për shqiptarët etnik, nëse funksionin e kryen pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike, në pyetje është niveli i "brenjosjes" për problemet e tyre, por megjithatë janë të përgatitur për situatë të tillë.

Në krahasim me vitin 2009, niveli i përgjithshëm i mbështetjes për kryerjen e funksioneve të larta shtetërore nga ana e pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike është zvogëluar nga 66% në 58%.

E ngjashme është mbështetja e mundësisë të tillë, kur bëhet fjalë konkretisht për shqiptarët etnik (54,3%), turqit (56,2%), ndërsa bëhet pakicë kur janë në pyetje romët (45,8%).

Sa i përket funksioneve konkrete shtetërore, tabela në vijim e prezanton pranueshmërinë e përgjithshme për, në secilën prej tyre të gjendet pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike nga ajo e qytetarit të anketuar, si dhe ndarja sipas dy bashkësive më të mëdha.

Tabela 5. Pranueshmëri pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike të zgjidhet për (në %):

	Po	Jo	ND/PP	Maq.*	Shq.*
Kryetar i Republikës së Maqedonisë	39,5	57,7	2,8	24,7	74,4
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë	50,7	46,0	3,4	40,0	70,0
Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë	41,5	54,5	4,1	28,1	71,0
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë	49,3	46,6	4,1	37,0	75,6
Kryetar i Gjyqit Suprem të Republikës së Maqedonisë	48,8	46,8	4,4	35,7	78,2
Kryetar i Këshillit Gjyqësor Republikan	53,6	42,5	3,9	42,8	77,5
Prokuror publik i Republikës së Maqedonisë	54,5	41,9	3,6	44,3	76,0
Avokat i Popullit të Republikës së Maqedonisë	54,4	42,0	3,6	44,7	72,9
Ministër i punëve të jashtme	48,0	49,4	2,6	35,9	76,0
Ministër i mbrojtjes	45,2	51,6	3,3	31,6	77,5
Ministër i punëve të brendshme	44,6	51,6	3,8	30,9	76,3
Ministër i drejtësisë	50,6	46,0	3,4	39,3	73,7
Ministër i financave	54,9	41,3	3,7	45,5	76,3
Gubernator i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë	52,5	42,6	4,9	41,6	77,9
Kryeshef i Shtatmadhorisë së ARM	42,8	53,0	4,2	28,0	77,1

* në dy kolonat e fundit (përkatësia etnike maqedonase dhe shqiptare) janë cekur përqindjet për përgjigjet "Po"

Përfundime për pranueshmërinë e udhëheqjes politike nga bashkësia tjetër etnike

Marrë në përgjithësi, akoma ka **mbështetje shumicë** (57,9%) që pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike të zgjidhet në funksion të lartë politik, por kjo mbështetje është zvogëluar në krahasim me vitin 2009 (66%).


Për shumicën e qytetarëve të Maqedonisë, **është e pranueshme që** pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike të jetë në njërin nga funksionet që vijojnë (sipas raportit të përgjigjeve "po" dhe "jo", prej 1, 3 deri 1): ministër i financave dhe i drejtësisë, prokuror publik, Avokat i popullit, kryetar i Këshillit gjyqësor republikan, guvernator i Bankës Popullore, kryetar i Kuvendit, kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjyqit Suprem.

Mbështetja është pakicë për pjesëtar të bashkësive tjera etnike të zgjidhet në funksionet: ministër i punëve të jashtme, për mbrojtje dhe punë të brendshme, kryeshef i Shtatmadhorisë së ARM, e më së paku është e pranueshme për funksionet kryetar i Qeverisë dhe kryetar i Republikës së Maqedonisë.

Në të gjitha rastet mbështetja e maqedonasve etnik është pakicë (prej 24% deri 45%), derisa te shqiptarët etnik ka shumicë të madhe (prej 70% deri 78%).

IV. LUFTA KUNDËR DISKRIMINIMIT

Grafiku 14. Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose shqetësimit, a do të kërkonte mbrojtje nga institucionet, organizatat relevante?




Shumicë e madhe e qytetarëve (72,3%) kanë deklaruar se nëse janë viktimë e diskriminimit ose shqetësimit do ta paraqisnin rastin.

Por, kjo nuk korrespondon me realitetin për vetëm 47 raste të paraqitura (vetëm te Avokati i Popullit) në tre vitet e fundit, si edhe deklaratat e cekura më lartë në disa nga pyetjet paraprake (për 19,1% viktima dhe 23,4% dëshmitarë të diskriminimit).

Në rast të tillë, qytetarët kryesisht do të drejtoheshin në polici (36,5%), te Avokati i Popullit (21,5%), e pastaj në gjykatë (11,9%) ose te avokati (11,2%), ndërsa pjesë e vogël do të drejtoheshin deri te ndonjë organizatë qytetare (7,6%) ose institucion tjetër. Kjo është renditja e parapëlqyer të të gjitha bashkësitë etnike, me përjashtim të vogël të shqiptarët etnik, të cilët kryesisht do të drejtoheshin te Avokati i Popullit, e pastaj në polici, derisa para avokatëve i preferojnë të gjykatat dhe organizatat qytetare.

Ky rezultat (besimi në polici) është gjithashtu në kundërshtim të pjesshëm me perceptimin për diskriminimin e madh (55,7%) pikërisht në polici (e treta nga të gjitha institucionet e përmendura).

Grafiku 15. Ku do të drejtoheshit për mbrojtje nga diskriminimi?



Përfundime për institucionet për luftë kundër diskriminimit

Shumicë e madhe, **72% të qytetarëve do ta paraqisnin rastin e diskriminimit** në bazë të përkatësisë etnike, nëse kjo u ndodh atyre ose janë dëshmitarë.

Kjo **nuk është në pajtim me përgjigjet** në pyetjet për përvojat personale me rastet e diskriminimit (viktima ose dëshmitarë) prej 31,9% **dhe praktika** (numri i rasteve të paraqitura në institucionet gjatë viteve të fundit, prej rreth 20 raste në vjet – të gjitha te Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë).

Për dallim nga veprimi i saj i perceptuar diskriminues, **policia është institucioni të cilit së pari do ti drejtoheshin** pjesa më e madhe e qytetarëve në rast të diskriminimit (te shqiptarët etnik para policisë gjendet vetëm Avokati i Popullit).

Shtojca 1: Pyetësor anketues për diskriminimin dhe shqetësimin në bazë të përkatësisë etnike

I NË PËRGJITHËSI – KONTEKSTI

P1. A do të kishit mundur të më thoni çfarë mendoni, sa është e shpeshtë secila prej formave të cekura të diskriminimit në Republikën e Maqedonisë? Diskriminimi në bazë të...

	Shumë i shpeshtë	Pothuaj i shpeshtë	Pothuaj i rrallë	Shumë i rrallë	Nuk ekziston (spontane)	ND	PP
e1	Përkatësia etnike						
e2	Seksi/Gjinia						
e3	Orientimi seksual						
e4	Mosha						
e5	Religjioni ose besimi fetar						
e6	Invaliditeti						
e7	Përkatësia partiake						

P2. (e8) Nëse e krahasoni situatën e tanishme me atë prej para pesë viteve, a do të kishit thënë se diskriminimi në bazë etnike është më i shpeshtë ose më i rrallë?

- 1 – Shumë më i shpeshtë
 2 – Mjaft i shpeshtë
 3 – As i shpeshtë, as i rrallë (njëlloj)
 4 – Mjaft i rrallë
 5 – Shumë më i rrallë
 Nuk e di (spontane) / Pa përgjigje (spontane)

P3. Në 12 muajt e fundit :

	Jo	Po	ND	PP
e9	Personalisht jeni ndjerë i diskriminuar/shqetësuar për shkak të përkatësisë etnike?			
e10	Keni qenë dëshmitar i diskriminimit ose shqetësimi për shkak të përkatësisë etnike?			
e11	Përmendni shembull			

P4. Sipas jush diskriminim në bazë etnike a ka në ofrimin e shërbimeve:

	Jo	Po	ND	PP
e12	Siguria dhe policia (mbrojtja/intervenimet, dhënia lejeve, certifikatat, dokumentet e udhëtimit, letrat e njoftimit, shtetësia etj.)			
e13	Jurisprudenca (prokuroria, gjyqësia, institucionet për kryerjen e sanksioneve etj.)			
e14	Financat publike (dogana, tatimet, denacionalizimi)			
e15	Ekonomia (lejet për import-eksport, koncesionet, licencat)			
e16	Bujqësia (subvencionet, lejet, qasja deri te mjetet nga IPARD)			
e17	Shëndetësia (sigurimi shëndetësor, shërbimet shëndetësore –kontrollet, mjekimi, recetat, ndihmesat ortopedike, lindja)			
e18	Arsimi (regjistrimi në shkollat shtetërore, dhënia e bursave, akreditimet, nostrifikimi i diplomave)			
e19	Shërbimet sociale (ndihma sociale, adoptimi, kompensimet tjera)			
e20	Kultura (mbështetja financiare e artistëve, institucionet dhe projektet librat, filmat, shfaqet teatrore etj.)			
e21	Urbanizmi (lejet për ndërtim, blerja e banesave, dhënia me qira e tokës për ndërtim, planet urbanistike etj.)			

II SIGURIA DHE POLICIA

P5. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke e përdorur shkallën nga 1 deri 10

e22	Policia e siguron rendin publik dhe sigurinë pa dallim të strukturës etnike të bashkësisë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Policia nuk e siguron rendin publik dhe sigurinë në bashkësinë time për shkak të strukturës etnike
e23	Policia i ndjek kriminelët pa dallim të përkatësisë së tyre etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Policia u ndjek kriminelët varësisht nga përkatësia e tyre etnike

III JURISPRUDENCA

P6. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke e përdorur shkallën nga 1 deri 10

Ju lutem më tregoni cila nga deklaratat që vijojnë është më afër qëndrimit Tuaj

e24	Sundimi i të drejtës dhe zbatimi i ligjeve zbatohet njëjloj në gjithë territorin e vendit, pa dallim të strukturës etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Sundimi i të drejtës dhe zbatimi i ligjeve nuk zbatohet njëjloj në gjithë territorin e vendit, varësisht nga struktura etnike
e25	Gjykatat i udhëheqin procedurat dhe i shqiptojnë dënimet pa dallim të përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Gjykatat i udhëheqin procedurat dhe i shqiptojnë dënimet varësisht nga përkatësia etnike

IV FINANCAT

P7. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke e përdorur shkallën nga 1 deri 10

e26	Buxheti i Republikës së Maqedonisë shpërndahet në bazë të kriterëve objektive pa dallim të përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Buxheti i Republikës së Maqedonisë shpërndahet me favorizimin e bashkësive tjera etnike (jo timen)
e27	Pjesëtarët e disa bashkësive etnike nuk paguajnë tatime, e kjo nuk sanksionohet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Mos pagesa e tatimeve sanksionohet pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike
e28	Qasje deri te kreditë në banka sigurohet pa dallim të përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Bankat në qasjen deri te kreditë i favorizojnë bashkësitë tjera etnike (jo timen)

V PUNËSIMI

P8. A pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratën që vijon

		Pajtohem	Nuk pajtohem	As pajtohem, as nuk pajtohem (spontane)	ND	PP
e30	Bashkësitë tjera etnike i marrin vendet e punës nga bashkësia ime					

P9. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke përdorur shkallën nga 1 deri 10

e31	Kur ka mungesë të mundësive për punësim, punëdhënësit duhet ti japin përparësi pjesëtarëve të bashkësisë së tyre etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Edhe në kushte të mungesës së mundësive për punësim, zgjidhja duhet të jetë në bazë të kriterëve objektive, pa dallim të përkatësisë etnike
-----	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	---

P10. Sipas jush a ka diskriminim gjatë punësimit në

		Jo	Po	ND	PP
e32	Sektorin shtetëror				
e33	Sektorin privat				

P11. A do të ishit pajtuar ose do të ishit kundër vendosjes së masave specifike afirmative për sigurimin e mundësive të barabarta për punësimin e personave nga bashkësitë etnike jo shumicë? Për shembull, masa të tilla janë: programet speciale për trajnim, kuotat për punësim, nxitjet tatimore, vendosja e standardeve për përgjegjësi shoqërore etj.

		Plotësisht pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Pjesërisht nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	ND	PP
e34	Në sektorin shtetëror						
e36	Në sektorin privat						

VI BUJQËSIA

P12. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke e përdorur shkallën nga 1 deri 10

Ju lutem më tregoni cila nga deklaratat që vijojnë, është më afër qëndrimit Tuaj

e37	Subvencionet në bujqësi miratohen në bazë të kriterëve objektive pa dallim të përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Subvencionet në bujqësi nuk miratohen në bazë të kriterëve objektive dhe u jepet përparësi bashkësive tjera etnike
-----	--	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	--

VII ARSIMI

P13. Me cilën nga deklaratat që vijojnë pajtoheni, duke përdorur shkallën nga 1 deri 10

Ju lutem më tregoni cila nga deklaratat që vijojnë, është më afër qëndrimit Tuaj

e38	Nxënësit nga bashkësia e njëjtë etnike duhet të mësojnë në shkollë të njëjtë në ndërtesë të veçantë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nxënësit nga bashkësi e njëjtë etnike duhet të mësojnë në shkollë të integruara/të përziera
e39	Nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike në shkollë të njëjtë, duhet të mësojnë në ndërrim të njëjtë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nxënësit nga bashkësi të ndryshme etnike në shkollë të njëjtë, duhet të mësojnë në ndërrime të ndryshme
e40	Nxënësit nga bashkësi të ndryshme etnike të cilët mësojnë në gjuhë të njëjtë duhet të mësojnë të grupuar në paralele të ndara etnike	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nxënësit nga bashkësi të ndryshme etnike të cilët mësojnë në gjuhë të njëjtë duhet të mësojnë në paralele etnikisht të përziera
e41	Romët duhet të mësojnë të grupuar në paralele rome	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Romët duhet të mësojnë në paralele etnikisht të përziera

VIII MEDIUMET**P14. (e42) A mendoni se diversifikimi në bazë etnike është mjaft i pasqyruar në medime?**

0 – Jo

1 – Po

Nuk e di (spontane) / Pa përgjigje (spontane)

P15. (e43) A mendoni se mediumet nxisin diskriminim, stigmatizim ose shqetësim ndaj ndonjë bashkësie etnike?

0 – Jo

1 – Po

Nuk e di (spontane) / Pa përgjigje (spontane)

P16. (e44) Sipas jush cili medium në Maqedoni më së shumti nxitë diskriminim, stigmatizim ose shqetësim ndaj ndonjë bashkësie etnike? (përgjigje spontane)**IX TJETËR****P17. Ju lutem më thoni cila nga deklaratat që vijojnë është më e afërt me qëndrimin tuaj**

e45	Qasja deri te objektet për sport, rekreacion, argëtim, hotelieri duhet të jetë njëloj për të gjithë qytetarët	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Objektet për sport, rekreacion, argëtim, hotelieri, mund të jenë si klube – të caktojnë qasje vetëm për anëtarët e një grupi të caktuar etnik
e46	Njerëzit duhet të jetojnë në lagje etnikisht të përziera	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Të gjithë duhet të jetojnë në lagje në grupet e tyre etnike

X FUNKSIONE UDHËHEQËSE DHE LUFTA KUNDËR DISKRIMINIMIT**P18. (e) A është për ju e pranueshme të zgjidhet në funksion të lartë politik**

		Jo	Po	ND	PP
e47	Pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike				
e48	Shqiptar/shqiptare etnike				
e49	Turk/turke etnike				
e50	Rom/rome etnike				

P19. A është për ju e pranueshme që pjesëtar i bashkësisë tjetër etnike të zgjidhet për:

		Jo	Po	ND	PP
e51	Kryetar i Republikës së Maqedonisë				
e52	Kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë				
e53	Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë				
e54	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë				
e55	Kryetar i Gjyqit Suprem të Republikës së Maqedonisë				
e56	Kryetar i Këshillit Gjyqësor Republikan				
e57	Prokuror publik i Republikës së Maqedonisë				
e58	Avokat i Popullit të Republikës së Maqedonisë				
e59	Ministër i punëve të jashtme				
e60	Ministër i mbrojtjes				
e61	Ministër i punëve të brendshme				
e62	Ministër i drejtësisë				
e63	Ministër i financave				
e64	Guvernator i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë				
e65	Kryeshef i Shtatmadhorisë së Armatës së Republikës së Maqedonisë				

P20. (e66) Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose shqetësimit, a do të kërkonti mbrojtje nga institucionet, organizatat relevante?

0 – Jo

1 – Po

Nuk e di (spontane) / Pa përgjigje (spontane)

P21. (e67) Ku do të drejtoheni që të kërkonti ndihmë (zgjidhni një përgjigje):

1 – Gjykata

2 – Policia

3 – Avokati i Popullit

4 – Avokati

5 – Sindikata

6 – Organizatë qytetare

7 – Tjetër

Nuk e di / Pa përgjigje

Shtojca 2: Ekземplar i qytetarëve të anketuar (1.074)

H1 (e68). Gjinia

- 1 – Mashkull (52,9%)
- 2 – Femër (47,1%)

H2. Moshë

- 1 – deri 30 vjet (37,9%)
- 2 – prej 31 deri 40 (23,3%)
- 3 – prej 41 deri 50 (18,2%)
- 4 – prej 51 deri 60 (13,4%)
- 5 – mbi 60 (7,2%)

H3 (e69). Përkatësia etnike

- 1 – Maqedonas/e (66,9%)
- 2 – Shqiptar/e (24,4%)
- 3 – Turk/e (2,0%)
- 4 – Rom/e (4,5%)
- 5 – Serb/e (2,0%)
- 6 – Vllah/e (0,1%)
- 8 – Tjetër (0,2%)

H4 (e70). A i takoni ndonjë religjioni përkatës?

- 1 – Ortodokse (66,1%)
- 2 – Islame (30,7%)
- 3 – Katolike (0,3%)
- 4 – Tjetër (0,7%)

H5 (71). Pa dallim a i takoni një religjioni të caktuar, a mendoni se jeni

- 1 – Personalitet religjioz (76,5%)
- 2 – Personalitet jo religjioz (15,1%)
- 3 – Ateist (2,0%)

H6 (e72). Statusi i punës

- 1 – I punësuar në sektorin publik (18,0%)
- 2 – I punësuar në sektorin privat (33,3%)
- 3 – Bujk (2,8%)
- 4 – Student (13,6%)
- 5 – Amvisë (4,4%)
- 6 – I papunësuar (20,8%)
- 7 – Pensionist (7,2%)

H7 (e73). A do ta kishit përshkruar veten se i takoni:

- 1 – Klasës së lartë (4,1%)
- 2 – Klasës së mesme të lartë (22,0%)
- 3 – Klasës së mesme më të ulët (38,0%)
- 4 – Klasës punëtore (23,2%)
- 5 – Klasës më të ulët (7,2%)

H8 (74). Arsimi

- 1 – Arsimi fillor i papërfunduar (2,6%)
- 2 – Fillor (11,3%)
- 3 – I mesëm (48,9%)
- 4 – I lartë, sipëror (37,2%)

H9 (e75). Vendi i banimit

- 1 – Rural (fshat) (28,4%)
- 2 – Urban (qytet) (54,4%)
- 3 – Shkup (17,2%)

H10 (e76). Cilit grup i takon amvisëria juaj. Ju lutem caktoni shumën adekuate të ardhurave mujore për anëtar në amvisëri, duke llogaritur të gjitha të ardhurat familjare

deri 1.500 den.	1.500-3.000 den.	3.000 – 4.000 den.	4.000 – 5.000 den.	5.000 – 6.500 den.	6.500 – 8.000 den.	8.001 – 11.000 den.	11.001 - 15.000 den.	15.001 - 24.000 den.	mbi 24.000 den..
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
5,0%	7,4%	6,9%	7,5%	9,5%	9,4%	13,4%	12,3%	12,4%	11,8%

H11 (e77). Në kuptimin politik, njerëzit flasin për orientim “të majtë” dhe “të djathtë” (e majta/e djathta). Në shkallën që vijon ku do të gjendeshin ju me bindjet dhe qëndrimet tuaja?

prej 1 deri 5 - majtas (22,6%)
prej 6 deri 10 – djathtas (23,1%)
-1 – Nuk e di
-2 – Pa përgjigje

H12 (e78). Ndaj cilës parti politike jeni simpatizues? (nuk lexohen partitë)

VMRO-DPMNE (15,2%)
LSDM (10,8%)
BDI (7,5%)
PDSH (3,2%)
DR (1,5%)

H13 (e79). Rajoni

1 – I Shkupit (24,2%)
2 – Juglindor (7,1%)
3 – Lindor (11,2%)
4 – Verilindor (9,3%)
5 – I Vardarit (6,5%)
6 – Jugperëndimor (10,6%)
7 – I Pollogut (16,3%)
8 – I Pellagonisë (14,8%)

Shtojca 3: Te,at në fokus grupet

1. Termet, shkaqet dhe vetëdija për shpërndarjen e diskriminimit etnik
2. Pse mendoni se ekziston dallim mes përvojës dhe mendimit tuaj se diskriminimi etnik është i përhapur?
3. Pse policia n ndryshëm do të sillej varësisht nga bashkësia etnike?
4. Favorizimi etnik gjatë distribuimit të buxhetit dhe mos pagesa e tatimeve
5. Favorizimi etnik gjatë punësimit në sektorin shtetëror dhe privat
6. Pranueshmëria e shkollave etnikisht të përziera
7. Pranueshmëria e personave nga bashkësia tjetër etnike për funksione publike